



Marrëveshje Bashkëpunimi midis

AGJENCIA KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE (ALCIRT)

dhe

NJËSIA NACIONALE PËR SIGURI KIBERNETIKE (KOS-CERT)

Këtej e tutje, Palët,

Të Vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të përmirësuar aftësitë mbrojtëse nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit mbi sigurinë kibernetike; dhe

Të Bindur që ky bashkëpunim i ndërsjelltë do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë;

Me Dëshirën E Mirë për të kontribuar në bashkëpunimin nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve;

Duke Deklaruar gadishmërinë e tyre në ndërmarrjen e aktiviteteve në kuadër të harmonizimit të legjislacionit dhe të zgjerimit të bashkëpunimit të tyre të ndërsjelltë në fusha me interes të përbashkët, duke krijuar kështu një kuadër dhe mjedis mbështetës bazuar në barazi, mosdiskriminim, dhe në një baraspëshë të të drejtave dhe detyrimeve;

Duke Riafirmuar vendoshmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve;

Kanë Vendosur, në ndjekje të këtyre objektivave, të konkludojnë Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1
Qëllimi

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim bashkëpunimin në fushat kryesore për të rritur informimin dhe shkëmbimin e informacionit në një infrastrukturë të hapur, ndërvepruese, të sigurt, dhe të besueshme duke pasur prioritet inovacionin në Internet.



Neni 2
Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

Të dy institucionet konfirmojnë që ndajnë të njëjtin qëndrim për sa i përket sigurisë kibernetike. Palët angazhohen të punojnë mbi parimin e reciproritetit për të asistuar, bashkëpunuar, në fushën e sigurisë kibernetike, duke respektuar privatësinë e njëra-tjetrës.

Neni 3
Angazhimet e palëve

Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) dhe KOS-CERT angazhohen që;

- Të bashkëpunojnë për trajtimin e incidenteve në hapësirën kibernetike.
- Të shkëmbejnë përvojat në fushën e sigurisë kibernetike dhe të krijojnë hapësira për pjesëmarrje në aktivitetet ndërkombëtare të fushës.
- Të vendosin në dispozicion programet dhe trajnimet që kanë qëllim ngritjen dhe avancimin e stafit të tyre.
- Të identifikojnë mundësitë për shkëmbime akademike dhe bashkëpunim në kërkim dhe zhvillim.

Neni 4
Komunikimi i palëve

- Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet me e-mail.
- Palët do të caktojnë një person kontakti me njohuri të specializuara të fushës që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.

Neni 5
Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të Palëve.

Neni 6
Afati

Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo

Marrëveshje, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 7

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja e sipërme do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit të saj nga titullarët e palëve.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 24/10/2016, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Njësinë Nacionale për Siguri Kibernetike (KOS-CERT) dhe dy të tjera në Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

**PËR NJËSINË NACIONALE PËR SIGURI
KIBERNETIKE (KOS-CERT)**

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE
PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve
Elektronike dhe Postare (ARKEP)**

Kryetar i Bordit
Z. KRËSHNIK GASHI



DREJTOR
Znj.ROVENA BAHITI

